



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 20.2.2021

R A P O R T

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, SI AUTORITET
KONTRAKTUES, DHE SHOQËRIVE “S2 ALBANIA”, SH.P.K., DHE “RAPISCAN
SYSTEMS”, INC, “PËR NJË NDRYSHIM NË MARRËVESHJEN E KONCESIONIT
PËR FINANCIMIN, NGRITJEN DHE OPERIMIN E SHËRBIMIT TË SKANIMIT TË
KONTEJNERËVE E AUTOMJETEVE TË TJERA NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË, MIRATUAR ME LIGJIN NR.123/2013”, TË NDRYSHUAR”**

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 20 shkurt 2021, shqyrtoi projektligjin “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “S2 Albania”, sh.p.k., dhe “Rapiscan Systems”, INC “Për një ndryshim në marrëveshjen e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.123/2013”, të ndryshuar”. Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj sipas rregullave të parashikuara në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relator, për këtë projektligj, z. Ervin Bushati.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të ftuar, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Znj. Vasilika Vjero, Zëvendësministre;
- Z. Edmond Ahmeti, Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve.

II. Baza ligjore.

Këshilli i Ministrave e ka propozuar projektligjin bazuar në nenet 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, si dhe në nenin 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në

Republikën e Shqipërisë”. Projektligji shoqërohet me relacionin përkatës, sipas kërkesave të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit.

III.1. Historik i shkurtër mbi kontratën e koncesionit.

Kontrata e koncesionit është miratuar përmes akteve ligjore si më poshtë:

Kontrata fillestare: Ligji nr.123/2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërisë “Rapiscan Security, INC.”, si koncesionar, për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të konteinerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”.

Kontrata e koncesionit parashikon që shoqëria “Rapiscan Security, INC” të realizojë projektin “Për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të konteinerëve e automjeteve të tjera”. Kjo kontratë është parashikuar të ketë një afat prej 15 vjetësh.

Tarifa e shërbimit të skanimit të konteinerëve dhe automjeteve të tjera, sipas këtij ligji, është 39 euro për deklaratë (pa përfshirë TVSH-në). Ky shërbim parashikohet me shkallë zero të TVSH. Për deklaratat me vlerë më të vogël se 1000 euro nuk parashikohet tarifë për shërbimin e skanimit.

Rapiscan i paguan palës shqiptare (Ministrisë së Financave) një tarifë koncesionare, prej 2% të të ardhurave, për ofrimin e shërbimit të skanimit. Kjo tarifë koncesionare mbahet nga pagesat që Ministria e Financave i detyrohet shoqërisë “Rapiscan”.

Ministria e Financave, si autoritet kontraktues, mbledh të ardhurat nga tarifa dhe kryen pagesën tek koncesionari në bazë mujore, brenda datës 20 të muajit pasardhës.

Shoqërisë “Rapiscan” i jepet e drejta që të themelojë një shoqëri tjetër për ofrimin e shërbimeve të përcaktuara në kontratë. Por edhe pas transferimit të detyrimeve, Rapiscan mbetet garantues për zbatimin e kontratës nga shoqëria tjetër.

Transferimi i kontratës.

Në korrik të vitit 2013 Shoqëria “Rapiscan” i shiti aksionet tek Shoqëria “S2 Albania”, sh.p.k.

Ligji nr. 74, datë 28.4.2015.

Ky ligj parashikoi zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve midis palëve, për shkak të të cilave çështja ishte në shqyrtim në Gjykatën e Arbitrazhit.

Ligji 74/2015 bëri këto ndryshime kryesore në kontratën e koncesionit:

- Tarifa e shërbimit të skanimit për deklaratat doganore me vlerë më të madhe se 1 000 euro, u reduktua nga 39 euro, në 22 euro;
- Për deklaratat doganore, me vlerë më të vogël ose të barabartë me 1 000 euro, u vendos një tarifë prej 5 eurosh.

Të ardhurat nga tarifa derdhen në buxhetin e shtetit.

Me këtë ligj Shoqëria “Rapiscan” vazhdon të jetë garantuese e kontratës.

Ligji 118/2015.

Ky ligj miratoi një ndryshim në kontratën për shërbimin e skanimit, duke përjashtuar nga pagesat e tarifës, deklaratat doganore për mallrat e vendosura në regjimin e tranzitit; mallrat që dalin nga regjimi i magazinimit doganor drejt një destinacioni tjetër doganor; mallrat që hyjnë dhe dalin nga magazinat e lira me procedurë rieksporiti; asgjësimin apo shkatërrimin e mallrave; mallrat që vendosen në qarkullim të lirë, pas vendosjes në regjimet doganore pezulluese; mallrat e importuara nën regjimin e përpunimit aktiv; transferimet nga një regjim pezullues në tjetrin; importet rastësore të mallrave me natyrë jotregtare.

III.2. Parashikimet e projektligjit.

Marrëveshja që propozohet të ratifikohet me këtë projektligj, parashikon shtyrjen e afatit të pagesës për tarifën e shërbimit të skanimit për muajt shtator, tetor dhe nëntor 2020, si dhe të detyrimit të papaguar të kësaj tarife për muajin gusht 2020. Vlera e papaguar e tarifës është rreth 3.4 milionë euro. Kjo vlerë do t’i paguhet koncesionarit gjatë vitit 2022, duke u shpërndarë në mënyrë proporcionale në vlerën 279.6 mijë euro për çdo muaj.

Vlera prej 279.6 mijë eurosh në muaj do t’i shtohet këstit të rregullt mujor të pagesave të vitit 2022. Shpenzimet totale të buxhetit të shtetit për tarifën e shërbimit të skanimit për vitin 2022 parashikohen në vlerën rreth 16.6 milionë euro, nga të cilat:

- Detyrimi për vitin 2022 13.2 milionë euro,
- Detyrimi i papambetur i vitit 2020 3.4 milionë euro.

Shoqëria koncesionare nuk do të aplikojë kamatëvonesa për shtyrjen e pagesave sipas marrëveshjes.

Shëqëria “Rapiscan” vijon të jetë garantuese e kontratës.

Arsyeja e mospagesës dhe shtyrjes së detyrimit nga vendi ynë është situata e pandemisë shëndetësore COVID-19, e cila ndikoi në reduktimin e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore me aktet normative nr.15/2020 dhe nr.18/2020. Pagesa për kontratën koncesionare të shërbimit

të skanimit u reduktua me 400 milionë lekë. Për këtë arsye, me kërkesën e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë të muajit prill 2020, palët zhvilluan bisedime dhe ranë dakord për për shtyrjen e afatit të pagesës së detyrimeve të buxhetit të shtetit ndaj koncesionarit sipas marrëveshjes së propozuar për t'u ratifikuar me këtë projektligj.

V. Diskutimi në Komision.

Znj. Vasilika Vjero, Zëvendësministre e Financave, paraqiti projektligjin, duke theksuar se Ministria e Financave ka arritur një marrëveshje shumë të mirë, që i jep frymëmarrje buxhetit dhe ka arritur mirëkuptimin me kompaninë koncesionare për shtyrjen e afatit të pagesave për shërbimin e skanimit. Ajo theksoi se gjatë vitit 2020, për shkak të situatës së pandemisë shëndetësore, u reduktuan një sërë pagesash që lidhen me detyrimet koncesionare. Një ndër këto reduktime ishte pagesa e Shoqërisë “Rapiscan” në vlerën 400 milionë lekë, e cila u miratua me aktet normative për ndryshimin e buxhetit 2020. Për t'u bërë efektiv ky reduktim dhe për të marrë miratimin e kompanisë koncesionare, Ministria e Financave dhe Ekonomisë krijoi një grup pune dhe inicioni të gjithë procedurën ligjore për të riparë mundësinë e rinegocimit të marrëveshjes me koncesionarin. Grupi i punës ka punuar disa muaj, që prej muajit prill. Nga koncesionari kanë ardhur disa propozime se si këto të ardhura të munguara t'u ripagueshin atyre në kohë. Pas një negocimi shumë të mirë me kompaninë koncesionare, është marrë edhe miratimi i tyre për shtyrjen e pagesës së kësteve të tarifës së shërbimit të skanimit, në masën 100 për qind, sipas kësaj marrëveshjeje. E gjithë vlera prej 400 milionë lekësh që nuk iu dha kompanisë në kohë, do të fillojë t'i jepet që nga fillimi i vitit të ardhshëm.

Z. Ervin Bushati, në cilësinë e relatorit, paraqiti opinionin e tij për projektligjin, duke e konsideruar shumë të rëndësishëm për lehtësimin e buxhetit të shtetit dhe të ekonomisë së vendit, në kushtet e një viti mjaft të vështirë, për shkak të pandemisë COVID-19. Ai sugjeroi që marrëveshje të kësaj natyre duhet të miratohen edhe me kompani të tjera, për të lehtësuar buxhetin e shtetit, biznesin dhe ekonominë shqiptare në një moment kaq të vështirë.

VII. Përfundim.

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin me shumicë votash.

RELATORI
Ervin BUSHATI

KRYETARI
Anastas ANGJELI